



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 12 Datë 13.06.2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” - SUBJEKTIT “ECO ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) te subjektit “ECO ENERGY” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**ECO ENERGY**” SH.P.K me administrator Z. Krivis MECI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Sërriqes**, degë e Lumit Drin për prodhim energjie elektrike në fshatin Qam, Njësia Administrative Malzi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC QAM do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 34 800 ; Y - 46 61 686 ; Z - + 390 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 36 103 ; Y - 46 62 774 ; Z - + 349 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 36 103 ; Y - 46 62 774 ; Z - + 349 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 1.54 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 2.5 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.1 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 2.5 m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

